ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2024–2025

Shkolla Profesionale “Arben Broci” Shkodër

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Sëisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025) 9
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024–2025) 14
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025) 15
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024–2025) 15
Tabela 5: Perceptimi për sigurinën dhe kënaqësinën në punën aktuale (2024–2025) 20
Tabela 7: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025) 21
Tabela 11: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2024–2025) 23
Tabela 12: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024- 2025) 24
Tabela 9: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024–2025) 25

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2024-2025) 9
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 10
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025) 10
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 11
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024-2025) 11
Figura 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 13
Figura 7: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2025) 13
Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2025) 14
Figura 9: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 15
Figura 10: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 17
Figura 11: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024-2025) 17
Figura 12: Madhësia e kompanisë (2024-2025) 18
Figura 13: Lloji i kontratës (2024-2025) 18
Figura 14: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024-2025) 19

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 5
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 7
Të diplomuarit 2024–2025 9
Analiza e rezultateve 11
Statusi i punësimit 11
Lidhja e punës me fushën e arsimit 13
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 15
Niveli i pagave 15
Kushtet e punës 17
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 19
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 20
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 21
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 22
Të diplomuarit pa punë 22
Propozimet për përmirësim në shkollë 23
Planet për të ardhmen 25

Gjetjet kryesore

Ky raport krahasues paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës profesionale Arben Broci për vitet 2024 dhe 2025.

- Në vitin 2025, 59.7% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit, me një rënie prej 31.6 pikësh përqindje krahasuar me vitin 2024 (91.3%).
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit u rrit nga 8.7% (N=2) në vitin 2024 në 26.4% (N=19) në vitin 2025, një rritje prej 17.7 pikësh përqindje.
- Sipas drejtimit, punësimi një vit pas diplomimit shënoi ndryshime të ndjeshme: në Elektroteknikë e TIK niveli i punësimit u rrit nga 50% (2024) në 87.5% (2025), ndërsa në Termohidraulikë ra nga 66.7% (2024) në 22.2% (2025) dhe në Ndërtim nga 100% (2024) në 33.3% (2025). SHMT mbeti relativisht i qëndrueshëm (72.7% në 2024, 79.3% në 2025).
- Lidhja e punës me fushën e arsimit u përmirësua lehtësisht: 63.2% e të diplomuarve të punësuar në 2025 u shprehën se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit, kundrejt 58.8% në 2024 (+4.4 pikë përqindje).
- Sipas drejtimit, tabloja ndryshoi ndjeshëm mes dy viteve: në 2024, lidhja e punës me fushën e arsimit rezultoi më e lartë në drejtimet TIK dhe Elektroteknikë (100%), e ndjekur nga Termohidraulika (66.7%) dhe SHMT (54.5%). Në 2025, SHMT u bë drejtimi me lidhjen më të lartë (94.7%, +40.2pp krahasuar me 2024), ndërsa Elektroteknika ra në 83% (-17pp). Mekanika u shfaq me lidhjen më të ulët (25%).
- 51.2% e të gjurmuarve në 2025 pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë “shumë” dhe “jashtëzakonisht shumë”, kundrejt 47.6% në 2024 (+3.6 pikë përqindje).
- Sipas rezultateve të gjurmimit për vitin 2025, struktura e të ardhurave mujore paraqitet si më poshtë: 41.9% e të diplomuarve (N=13) raportojnë të ardhura deri në 50,000 lekë, 19.4% (N=6) në intervalin 50,001–60,000 lekë, 12.9% (N=4) në intervalin 60,001–80,000 lekë, 9.7% (N=3) në intervalin 80,001–95,000 lekë, 6.5% (N=2) në intervalin 95,001–120,000 lekë, ndërsa 9.7% (N=3) raportojnë të ardhura mbi 120,000 lekë.
- 80.6% e të diplomuarve në 2025 ndjehen “të sigurt” ose “shumë të sigurt” në vendin e punës, kundrejt 76.5% në 2024 (+4.1 pikë përqindje). Ndërkohë, pjesa e atyre që ndihen të pasigurt (shumë të pasigurt + të pasigurt) qëndroi në 9.7% në 2025.
- Të gjurmuarit e vitit 2025 vlerësojnë se nevoja për përmirësim në shkollë ka rënë krahasuar me 2024 në pothuajse çdo aspekt: praktika në shkollë (nga 80% në 62.9%, -17.1pp), bashkëpunimi me bizneset (nga 84.2% në 64.1%, -20.1pp) dhe këshillimi i karrierës (nga 76.2% në 60%, -16.2pp) mbeten prioritetet kryesore.
- Përzgjedhja e të njëjtës shkollë dhe degë ra ndjeshëm: në 2025, 66.7% e të diplomuarve do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim (nga 82.6% në 2024, -15.9pp) dhe 72.2% të njëjtën shkollë (nga 82.6% në 2024, -10.4pp).


- Brenda dy viteve të ardhshme, dëshira për të filluar biznesin personal ra nga 69.6% (2024) në 43.1% (2025, -26.5pp), ndërsa dëshira për emigrim jashtë vendit u rrit lehtësisht nga 4.3% në 6.9% ne 2025.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **Arben Broci Shkodër**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës krahasues pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i dy brezave të diplomuar në vitin 2024 dhe në vitin 2025 në shkollën Arben Broci.

Të diplomuarit 2024–2025


Në vitin shkollor 2023–2024, në shkollën Arben Broci Shkodër u diplomuan 89 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2024–2025 u diplomuan 73 nxënës (Shiko tabelën 1).

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025)1

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2023-2024	89	23	26%
2024–2025	73	72	98.6%

Nga të diplomuarit e vitit 2023–2024 u gjurmuan 23 nxënës (26%), ndërsa nga të diplomuarit e vitit 2024–2025 u gjurmuan 72 nxënës (98.6%) — një përmirësim i ndjeshëm i mbulimit të gjurmimit. Në të dy brezat, pjesa dërrmuese e të gjurmuarve ishin djem (100%, N=23 në 2024; 100%, N=72 në 2025) (Shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** (N=72)

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve në 2025 jepet në figurën 2. Përkatësisht, 20.8% e të gjurmuarve i përkasin drejtimit Elektroteknikë, 12.5% Termohidraulikë, 11.1% Mekanikë dhe po aq TIK, 4.2% Ndërtim, dhe 40.3% SHMT.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=72

Të pyetur lidhur me vendbanimin (Shiko figurën 3), në 2024, 82.6% (N=19) e të diplomuarve të gjurmuar jetonin në Shqipëri dhe 17.4% (N=4) jashtë vendit. Në 2025, 86.1% (N=62) jetonin në Shqipëri dhe 13.9% (N=10) jashtë vendit - një rritje e lehtë e qëndrimit në vend.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=23); **2025** (N=72)

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit 2023–2024, nga 23 të anketuar, 60.9% (N=14) ishin të punësuar, 17.4% (N=4) të vetë-punësuar, 13% (N=3) të punësuar e në të njëjtën kohë studentë, ndërsa 8.7% (N=2) ishin të papunë. Në brezin 2024–2025, nga 72 të anketuar, 37.5% (N=27) ishin të punësuar, 12% (N=12) të vetë-punësuar, 5.6% (N=4) të punësuar e njëkohësisht studentë, ndërsa 26.4% (N=19) ishin të papunë, një rritje e ndjeshëme e papunësisë krahasuar me vitin paraardhës.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2025** (N=72)

Sipas rezultateve të figurës 5, statusi i punësimit/vetë-punësimit të diplomuarve një vit pas diplomimit ka ndryshuar ndjeshëm mes brezave. Në brezin 2023-2024, 91.3% e të diplomuarve ishin të punësuar ose vetë-punësuar, ndërsa vetëm 8.7% ishin pa punë. Në brezin 2024-2025, pjesa e të punësuarve/vetë-punësuarve ra ndjeshëm në 59.7% (-31.6 pikë përqindje), ndërsa pjesa e atyre pa punë u rrit në 26.4% (+17.7 pikë përqindje). Gjithashtu, në 2025 u shfaqën dy kategori shtesë që nuk ishin raportuar veçmas në 2024: 5.6% e të diplomuarve rezultuan kursantë dhe 8.3% u klasifikuan në kategorinë "tjetër".

Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024-2025)



***Shënim**: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024**: N=23; **2025** (N=72)*

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Sipas rezultateve, pjesa e të diplomuarve të punësuar ra nga 60.9% (N=14) në 2024 në 37.5% (N=27) në 2025, një rënie prej 23.4 pikësh përqindje. Niveli i vetë-punësimit mbeti relativisht i qëndrueshëm, duke rënë lehtë nga 17.4% (N=4) në 2024 në 16.7% (N=12) në 2025 (-0.7 pikë përqindje).

Figura 5.1: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2023-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2014**: (N=23); **2025**: (N=72);

Në figurën 6, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Në vitin 2024, 50% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 66.7% në Termohidraulikë, 100% në Ndërtim, 72.7% në SHMT dhe 50% në TIK ishin të punësuar një vit pas diplomimit; 50% në Elektroteknikë, 100% në Mekanikë dhe 18.2% në SHMT ishin të vetë-punësuar. Në vitin 2025, niveli i punësimit u rrit ndjeshëm në Elektroteknikë e TIK (87.5%) dhe SHMT (79.3%), ndërsa ra në Termohidraulikë (22.2%) dhe Ndërtim (33.3%); 50% e të diplomuarve në Mekanikë ishin gjithashtu të punësuar.

Ndërkohë, papunësia sipas drejtimit në 2025 rezultoi më e lartë në Elektroteknikë (53.3%) dhe Termohidraulikë (44.4%), krahasuar me vetëm Elektroteknikë (50%) dhe TIK (50%) në 2024.

Sikurse e tregon edhe figura 6, në 2024, 33.3% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 9.1% në SHMT ishin të punësuar e njëkohësisht studentë; në 2025, kjo kategori u shpërnda më gjerësisht, me 6.7% në Elektroteknikë, 11.1% në Termohidraulikë dhe 25% në Mekanikë.

Figura 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: ELEK** (N=15); **TERM** (N=9); **MEK** (N=8); **NDER** (N=3); **SHMT** (N=29), **TIK** (N=8)

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 58.8% (N=10) e të diplomuarve në 2024 dhe 63.2% (N=27) në 2025 u shprehën se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit — një rritje prej 4.4 pikësh përqindje. Në 2025, 36.8% (N=16) u shprehën që puna nuk lidhet, kundrejt 41.2% në 2024.

Figura 7: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **2024**: N=17; **2025** N= 43

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (Shiko figurën 8), vërehen ndryshime të ndjeshme mes dy viteve. Në 2024, drejtimet TIK dhe Elektroteknikë kishin lidhjen më të

lartë (100%), të ndjekura nga Termohidraulika (66.7%) dhe SHMT (54.5%). Në 2025, SHMT u përmirësua ndjeshëm në 94.7% (+40.2pp krahasuar me 2024). Elektroteknika ra lehtë në 83.3% (-16.7pp), ndërsa Mekanika u shfaq me lidhjen më të ulët (25%).

Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. ; **Baza 2024:** N_{Ele}=1; N_{Ter}=6; N_{Mek}=1; N_{Nd}=1, N_{SHMT}=11, N_{TIK}=1 ; **2025**: N_{Ele}=6; N_{Ter}=2; N_{Mek}=4; N_{Nd}=1, N_{SHMT}=23, N_{TIK}= 7.
*Për të punësuarit dhe vetëpunësuarit së bashku

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (Shiko tabelën 2), të diplomuarit e brezit 2024 përmendën kryesisht pagën/kushtet më të mira të punës aktuale (42.9%) dhe pamundësinë për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (28.6%). Në 2025, arsyeja kryesore ishte mungesa e ofertave të punës në fushë në rajon (14.3%), ndërsa shumica (85.7%) e klasifikuan arsyen si "tjetër.

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024–2025)2

	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	**28.6%**	**0%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	**14.3%**	**14.3%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	**42.9%**	**0%**
Tjetër	**14.3%**	**85.7%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (N=7); 2025 (N=43)**

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (Shiko tabelën 3), 47.6% e të gjurmuarve në 2024 dhe 51.2% në 2025 pohojnë se i përdorin "shumë" ose "jashtëzakonisht shumë" (+3.6 pikë përqindje).

Ndërkohë, pjesa e atyre që deklarojnë se nuk i përdorin "aspak" njohuritë e fituara ra nga 23.8% në 2024 në 7% në 2025, ndërsa kategoria "disi/mesatarisht" u rrit nga 4.8% në 25.6%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025)3

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	23.8%	4.8%	23.8%	14.3%	33.3%
2025	7%	16.3%	25.6%	16.3%	34.9%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (N=21); 2025 (N=43)**

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (Shiko tabelën 4), 42.9% e të diplomuarve në 2024 dhe 53.5% në 2025 e vlerësojnë këtë lidhje me "shumë/jashtëzakonisht shumë" (+10.6 pikë përqindje). Vlerësimet "pak/aspak" u rritën gjithashtu, nga 4.8% (2024) në 11.6% (2025).

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024–2025)4


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	4.8%	9.5%	42.9%	4.8%	38.1%
2025	11.6%	11.6%	23.3%	18.6%	34.9%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2024 (N=21); 2025 (N=43)

Niveli i pagave

Në 2026 për shkak të ndryshimit të pagesës minimale (nga 40,000 lekë në 50,000 lekë) nga 1 janar 2026, janë rishikuar kategoritë e pagave ne pyetësor. Në 2025: 42% deri në 50,000 lekë, 19.4% në fashën 50,001 – 60, 000 lekë, 13% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë dhe 10% paguhen në fashën 80,001- 95,000 lekë, 6.5% në fashën 95,001 lekë – 120,000 lekë dhe 10% me më shumë se 120,000 lekë.

Figura 9: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=43

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (Shiko Figurën 10), për vitin 2025 tregojnë se: drejtimet Mekanikë dhe Elektroteknikë paraqesin përqindjet më të larta të të diplomuarve me të ardhura mbi 120,000 lekë, ndërsa drejtimi Ndërtim rezulton tashmë me nivelin më të ulët të të ardhurave, pasi të gjithë të diplomuarit e këtij drejtimi raportojnë të ardhura deri në 50,000 lekë. Drejtimi TIK, edhe pse shumica e të diplomuarve (80%) kanë të ardhura nën 50,000 lekë, dallohet nga një segment prej 20% që arrin intervalin 95,001–120,000 lekë.

Në drejtimin Elektroteknikë, gjysma e të diplomuarve (50.0%) raportojnë të ardhura në intervalin 50,001–60,000 lekë, ndërsa nga 16.7% ndahen përkatësisht në intervalet 60,001–80,000 lekë, 80,001–95,000 lekë dhe mbi 120,000 lekë.

Në drejtimin Mekanikë, shumica e të diplomuarve (66.7%) kanë të ardhura deri në 50,000 lekë, ndërsa pjesa tjetër (33.3%) raporton të ardhura mbi 120,000 lekë – përqindja më e lartë e këtij niveli krahasuar me çdo drejtim tjetër, duke e bërë Mekanikën drejtimin me potencialin më të lartë të të ardhurave të larta.

Në drejtimin Ndërtim, të gjithë të diplomuarit (100%) raportojnë të ardhura deri në 50,000 lekë, duke e renditur këtë drejtim me nivelin më të ulët të të ardhurave mes drejtimeve të analizuara.


Në drejtimin SHMT, të ardhurat janë më të shpërndara: 37.5% e të diplomuarve raportojnë të ardhura deri në 50,000 lekë, 18.8% në intervalin 50,001–60,000 lekë, po aq (18.8%) në intervalin 60,001–80,000 lekë, 12.5% në intervalin 80,001–95,000 lekë, dhe nga 6.3% përkatësisht në intervalet 95,001–120,000 lekë dhe mbi 120,000 lekë.

Në drejtimin TIK, shumica e të diplomuarve (80.0%) raportojnë të ardhura deri në 50,000 lekë, ndërsa 20.0% arrijnë intervalin 95,001–120,000 lekë, çka tregon një grup të vogël por me potencial ekonomik më të lartë brenda këtij profili.

Meqënëse fashat e pagave kanë ndryshuan mes viteve *(pragu i ulët u ngrit nga 40,000 në 50,000 lekë; u shtua fasha 60,001–80,000 lekë)*, prandaj krahasimi mes viteve mbetet i përgjithshëm. Drejtimi i Ndërtimit u përmbys plotësisht duke kaluar nga drejtimi më fitimprurës në 2024 (100%

mbi 120,000 lekë) në më të ulëtin në 2025 (100% deri në 50,000 lekë). TIK-u kaloi nga i përqendruar në pagat mesatarisht të larta (100% në 95,001–120,000 lekë) në kryesisht paga të ulëta (80% deri në 50,000 lekë). SHMT pa një rënie të pagave të larta (nga 33.3% në 2024 në 6.3% në 2025), ndërsa Mekanika u shfaq si drejtimi i ri me potencialin më të lartë (33.3% mbi 120,000 lekë).

Figura 10: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: NEle=6; NTer=2; NMek=4; NNd=1, NSHMT=23, NTIK= 7.

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës, 94.1% e të diplomuarve në 2024 punonin me kohë të plotë (5.9% kohë të plotë sezonale), ndërsa në 2025, 87.1% punonin me kohë të plotë, 9.7% me kohë të pjesshme dhe 3.2% kohë të plotë sezonale — një rënie e lehtë e punësimit me kohë të plotë (-7pp).


Figura 11: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=17); **2025** (N=43)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (Shiko figurën 12), në 2024, 52.9% punonin në kompani me 1–4 punonjës, 17.6% me 5–9, 23.5% me 10–49 dhe 5.9% me mbi 50 punonjës. Në 2025, mikrondërmarrjet (1–4 punonjës) mbetën mbizotëruese dhe u rritën në 71%, ndërsa 16.1% punonin në kompani me 5–9 punonjës, 3.2% me 10–49 dhe 9.7% me mbi 50 punonjës.


Figura 12: Madhësia e kompanisë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=17); **2025** (N=43)

Lidhur me llojin e kontratës, në 2024, 11.8% e të gjurmuarve kishin kontratë me afat të caktuar, 47.1% me afat të pacaktuar, 5.9% ishin në praktikë dhe 35.3% punonin pa kontratë. Në 2025, situata ka rënë ndjeshëm: vetëm 19.4% kishin kontratë me afat të pacaktuar, 29% me afat të caktuar, 5.9% ishin në praktikë, ndërsa pjesa e atyre pa kontratë u rrit në 51.6% (+16.3 pikë përqindje).


Figura 13: Lloji i kontratës (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=17); **2025** (N=43)

Lidhur me pagesën e kontributeve të detyrueshme nga punëdënësi (shiko figurën 14), 64.7% e të diplomuarve të punësuar në 2024 deklaruan se iu paguheshin, kundrejt 54.8% në 2025 (-9.9 pikë përqindje). Në 2025, 22.6% deklaruan se nuk iu paguheshin sigurimet dhe po aq (22.6%) shprehën se nuk kishin informacion, krahasuar me 17.6% për të njëjtën kategori në 2024.

Figura 14: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=17); **2025** (N=43)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës (Shiko tabelën 5), 76.5% e të diplomuarve në 2024 dhe 81.1% në 2025 (I/e sigurt + Shumë i/e sigurt) u shprehën se

ndjehen “të sigurt” ose “shumë të sigurt”, një përmirësim (+4.6pp). Pjesa e atyre që u shprehën “të pasigurt” ose “shumë të pasigurt” ra nga 11.8% (2024) në 9.7% (2025).

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 82.4% e të diplomuarve në 2024 dhe 77.4% në 2025 u shprehën se ndjehen “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” (-5pp). Pjesa e të pakënaqurve (shumë të pakënaqur + të pakënaqur) u rrit nga 5.9% (2024, vetëm kategoria “shumë e pakënaqur”) në 16.2% (2025).

Tabela 5: Perceptimi për sigurinën dhe kënaqësinën në punën aktuale (2024–2025)5

	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	11.8%	3.2%
I/e pasigurt	–	6.5%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	11.8%	9.7%
I/e sigurt	47.1%	48.8%
Shumë i/e sigurt	29.4%	32.3%
Shumë i/e pakënaqur	5.9%	6.5%
I/e pakënaqur	–	9.7%
As i kënaqur as i pakënaqur/ neutral	11.8%	6.5%
I/e kënaqur	70.6%	54.8%
Shumë i/e kënaqur	11.8%	22.6%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2024 (N=17); 2025 (N=43)

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Sipas të dhënave për periudhën që i'u duhej të diplomuarve për të gjetur punën e parë, shumica dërrmuese gjejnë punë menjëherë ose para diplomimit, dhe kjo prirje u forcua nga 2024 në 2025: 70.6% e të diplomuarve në 2024 gjetën punë para diplomimit ose menjëherë pas tij, ndërsa në 2025 kjo pjesë u rrit në 77.4%. Pjesa e atyre që gjetën punë brenda muajit të parë mbeti pothuajse e njëjtë (11.8% në 2024, 12.9% në 2025). Në 2024, 11.8% e të diplomuarve prisnin 1–3 muaj dhe 5.9% 6–9 muaj, ndërsa në 2025 këto kategori u zëvendësuan nga periudha pritjeje pak më të gjata: 3.2% prisnin 3–6 muaj dhe 6.5% 9–12 muaj. Në përgjithësi, procesi i gjetjes së punës së parë mbetet i shpejtë për shumicën e të diplomuarve në të dy vitet, me një përqendrim edhe më të madh drejt punësimit të menjëhershëm në 2025.

Tabela 6 : Periudha kohë në kërkim të një pune (2024–2025)

Periudha	2024	2025
Para diplomimit / menjëherë	70.6%	77.4%
1 muaj pas diplomimit	11.8%	12.9%
1–3 muaj	11.8%	
3–6 muaj		3.2%
6–9 muaj	5.9%	

9–12 muaj		6.5%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=21); 2025 (N=43)

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (Shiko tabelën 6), krahasuar me 2024, në 2025 u rrit lehtë pjesa e atyre që pohojnë se shkolla i ka mësuar si të aplikojnë për punë (nga 19% 2024 në 20.9% 2025) dhe veçanërisht pjesa e atyre të orientuar mbi mundësitë e punësimit (nga 23.8% në 30.2%). Pjesa e atyre që pohojnë se shkolla "përgjithësisht nuk i ka ndihmuar" mbeti pothuajse e njëjta (23.8% në 2024, 23.3% në 2025, N=10).

Tabela 7: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025)6

	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	**19%**	**20.9%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	**23.8%**	**30.2%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	**14.3%**	**7%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	**23.8%**	**23.3%**
Tjetër	**19%**	**20.9%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (N=21); 2025 (N=43)**

Mënyra kryesore e kërkimit të punës mbetet rrjeti personal në të dy vitet, dhe pesha e tij u rrit ndjeshëm: nga njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë u përdorën nga 56.3% e të diplomuarve pa punë në 2024 dhe u rritën në 67.7% në 2025 (+11.4pp). Praktika profesionale në biznes gjithashtu u rrit lehtë, nga 12.5% në 16.1% (+3.6pp). Nga ana tjetër, disa kanale u zbehën ose u zhdukën krejtësisht në 2025: kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin (18.8% në 2024, 0% në 2025) dhe ndihma nga mësuesit (6.3% në 2024, 0% në 2025) nuk u raportuan fare në 2025. Zyra e Punësimit mbeti një kanal dytësor, por pesha e saj u ul nga 6.3% në 3.2%. Në 2025 u shfaqën gjithashtu kanale të reja që nuk ishin raportuar në 2024: njoftimet online/media sociale/gazetë (3.2%), qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë (3.2%) dhe kategoria "tjetër" (6.5%). Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një varësi në rritje nga rrjeti shoqëror/familjar dhe një largim nga kanalet institucionale si mjete kërkimi pune.

Si e gjete punën tënde të parë?	2024	2025
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë		**3.2%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	**56.3%**	**67.7%**
Nga praktika profesionale në biznes	**12.5%**	**16.1%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	**18.8%**	
Nga mësuesit	**6.3%**	
Nga Zyra e Punësimit	**6.3%**	**3.2%**
Tjetër		**6.5%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë/mësuesit		**3.2%**

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Në 2024, 100% e të diplomuar që po ndjekin studimet po frekuentojne Universitetin, nga të cilët dy prej tyre në universitet publik. Në 2025, 75% të diplomuar që po ndjekin studimet po frekuentojne Universitetin ndërsa 25% një kurs professional. Ndëerkohë nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 75% studiojnë në institucione publike 25% në ato private.

Tabela 8: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024-2025)


Arsyeja për ndjekjen e studimeve	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	66.7% (N=2)	50% (N=2)
Për të rritur mundësinë për të gjetur një punë më të mirë	33.3% (N=1)	25% (N=1)
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale		25% (N=1)

Shënim: (N=3 në 2024, N=4 në 2025)

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit u rrit nga 8.7% (N=2) në 2024 në 26.4% (N=19) në 2025.

Figura15: Papunësia ndër vite (2024-2025)



Sipas Tabelës 9, në 2024 të gjithë të diplomuarit pa punë (100%, N=2) deklaruan se ishin duke kërkuar aktivisht punë. Në 2025, kjo pjesë ra në 63.2%, ndërsa 36.8% e të diplomuarve pa punë deklaruan se nuk po kërkonin punë, një kategori që nuk ishte raportuar fare në 2024.

Tabela 9: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024–2025)]

Arsyeja e papunësisë	2024	2025
Jam pa punë dhe po kërkoj për punë	**100%**	**63.2%**
Jam pa punë, por nuk po kërkoj për punë		**36.8%**

Shënim: Baza: 2024 (N=2); 2025 (N=19)

Sipas Tabelës 10, arsyet e deklaruara ndryshuan ndjeshëm mes dy viteve. Në 2024, të gjithë të diplomuarit pa punë (100%, N=2) e lidhën gjendjen e tyre me mungesën e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur punë. Në 2025, kjo arsye nuk u përmend fare; në vend të saj, shumica (71.4%) e lidhën papunësinë me mungesën e eksperiencës së punës, ndërsa 28.6% e lidhën me faktin që ofertat e disponueshme nuk lidheshin me fushën e tyre të arsimimit. Ky ndryshim tregon një zhvendosje të perceptimit të pengesave kryesore drejt tregut të punës.

Tabela 10: Arsyeja kryesore e papunësisë (2024-2025)

Arsyeja e mos kërkimit për punë	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës		**71.4%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim		**28.6%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	**100%**	

Shënim: Baza: 2024 (N=2); 2025 (N=19)

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës (Shiko tabelën), nevoja për përmirësim ra në pothuajse çdo aspekt nga 2024 në 2025. Prioritetet mbetën praktika në biznes (66.7% në 2025, nga 71.4% në 2024), bashkëpunimi me bizneset (64.1% në 2025, nga 84.2% në 2024) dhe metodat e mësimdhënies (58.6% në 2025, nga 61.9% në 2024), ndërsa rënia më e madhe u vu re tek praktika në shkollë (nga 80% në 2024 në 62.9% në 2025, -17.1pp) dhe këshillimi i karrierës (nga 76.2% në 2024 në 60% në 2025, -16.2pp).


Tabela 11: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024–2025)7

	2024	2025
Infrastruktura	57.1%	**50.8%**
Kurrikula	42.9%	**43.6%**
Tekstet dhe materialet	66.7%	**50%**
Metodat e mësimdhënies	61.9%	**58.6%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	70%	**58.6%**
Praktika në shkollë	80%	**62.9%**
Praktika në biznes	71.4%	**66.7%**
Këshillimi i karrierës	76.2%	**60%**
Bashkëpunimi me bizneset	84.2%	**64.1%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	73.7%	**62.3%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (N=23); 2025 (N=43)**

Nëse do të kishin mundësi, 82.6% e të diplomuarve në 2024 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe të njëjtën shkollë. Në 2025, kjo dëshirë ra ndjeshëm: 66.7% do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim dhe 72.2% të njëjtën shkollë (shiko figurën 15, grafik i pandryshuar).

Figura 16: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=23);**2025 (N=72)**

Të disagreguara sipas drejtimeve (shiko tabelën 12), përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë ra në pothuajse çdo drejtim nga 2024 në 2025. Për degën, rënia më e madhe u vu re në Mekanikë (nga 100% në 50%) dhe TIK (nga 100% në 75%), ndërsa Elektroteknika dhe SHMT ranë me rreth 15-33pp (Elektroteknikë: nga 100%→66.7%; SHMT: 90.9%→75.9%). I vetmi përmirësim ishte te Ndërtimi, ku përzgjedhja e së njëjtës degë u rrit nga 0% në 33.3%, megjithëse me bazë shumë të vogël (N=1 në 2024). Për shkollën, ndryshimi më i theksuar ishte te TIK (nga 100% në 50%) dhe Mekanika (nga 100% në 62.5%), ndërsa Elektroteknika mbeti relativisht e qëndrueshme (100%→93.3%) dhe Ndërtimi ruajti nivelin maksimal (100% në të dy vitet). Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një ulje të kënaqësisë me përzgjedhjen fillestare në shumicën e drejtimeve, me përjashtim të Ndërtimit, ku qëndrimi është përmirësuar.

Tabela 12: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024- 2025)8

		Elektroteknikë	Termohidraulikë	Mekanikë	Ndërtim	SHMT	TIK
2024	Degë	100%	66.7%	100%	0%	90.9%	100%
	Shkollë	100%	50%	100%	100%	90.9%	100%
2025	Degë	66.7%	55.6%	50%	33.3%	75.9%	75%
	Shkollë	93.3%	33.3%	62.5%	100%	79.3%	50%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2024:** N_{ELE}=2; N_{TER}=6; N_{MEK}=1; $N_{Ndër}$=1; N_{SHMT}=11, N_{TIK}=2; **2025:** N_{Ele}=6; N_{Ter}=2; N_{Mek}=4; N_{Nd}=1, N_{SHMT}=23, N_{TIK}= 7.

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet e tyre për të ardhmen e afërt (shiko tabelën), dëshira për të filluar biznesin personal mbetet prioriteti kryesor në të dy vitet, por ra ndjeshëm nga 69.6% (2024) në 43.1% (2025). Në ndryshim nga 2024, në 2025 u rrit ndjeshëm pjesa e atyre që duan thjesht të jenë të punësuar (nga 4.3% në 18.1%) dhe ata që duan një punë të lidhur me fushën e studimit (nga 17.4% në 22.2%). Dëshira për emigrim jashtë vendit u rrit lehtë (nga 4.3% në 6.9%), ndërsa interesi për studime të mëtejshme ra (nga 8.7% në 4.2%).

Tabela 9: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024–2025)9

	2024	2025
Të jem punësuar	4.3%	18.1%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	17.4%	22.2%
Të kem filluar biznesin tim	69.6%	43.1%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	8.7%	4.2%
Të kem emigruar jashtë vendit	4.3%	6.9%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0%	0%
Tjetër	0%	15.3%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: 2024 (N=23); 2025 (N=72)